



Konsultim rreth programit të asistencës financiare të para-aderimit në BE, IPA 2015 i organizuar nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri

Tiranë, 10 korrik 2015

Më 10 korrik 2015, në ambientet e ABA Business Center, Tiranë, një përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) mori pjesë në konsultimin rreth formës së përgjithshme të programit të asistencës financiare të para-aderimit në BE, për vitin 2015, të organizuar nga zyra e BE-së në Tiranë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si dhe Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike.

Fokusi i takimit ishin diskutimi rreth kontratave financiare midis BE-së dhe qeverisë tonë për mbështetje buxhetore në dy sektorë, respektivisht, Reforma në Sektorin e Administratës Publike si dhe Reforma mbi Punësimin dhe Profesionalizmin.

Në takim morën pjesë disa përfaqësues të zyrës së BE-së në Tiranë, dhe konkretisht z. Stefano Calabretta së bashku me disa ekspertë të fushës, përfaqësues nga dy Ministrinë tona, konkretisht Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si dhe përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile.

Temat rreth të cilave u diskutua në takim ishin si vijon:

- *Prezantimi i përgjithshëm i Programit IPA 2015*
- *Prezantimi i instrumentit për mbështetje buxhetore Sektoriale*
- *Prezantimi i rolit të Strategjisë së Reformës në Administratën Publike nga përfaqësuesi i ministrisë përfutuese*
- *Prezantimi i një Përmbledhjeje të Projektit për Reformën në Administratën Publike*
- *Prezantimi i rolit të Strategjisë së Punësimit dhe Profesionalizmit nga përfaqësuesi i ministrisë përfutuese*
- *Përmbledhje e Projektit rreth Punësimit dhe Profesionalizmit*

Në mbyllje të takimit pjesëmarrësit diskutuan edhe për takimin e radhës, i cili do të jetë në kuadër të diskutimit të Programit IPA 2016.



Takim i hapur për vendosjen e bashkëpunimit midis AMSHC-së, Bashkisë së Tiranës dhe organizatave të shoqërisë civile

Tiranë, 31 gusht 2015



Më datë 31 gusht 2015, në ambjentet e Bashkisë së Tiranës u zhvillua një takim i hapur, i organizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë, përfaqësuesve të AMSHC dhe përfaqësuesve të rreth 80 organizatave jo-fitimprurëse të shoqërisë civile, aktive kryesisht në promovimin e rinisë, ambjentit, personave në nevojë si dhe që promovojnë vullnetarizmin dhe veprojnë nëpërmjet rrjeteve të tyre të vullnetarëve.



Takimi, i cili është një nismë e AMSHC-së për të nxitur shoqatat e shoqërisë civile të bëhen pjesë aktive e vendimarrjes në iniciativat e autoriteteve të qeverisjes vendore, është vetëm fillimi i një bashkëpunimi afatgjatë mes AMSHC, Bashkisë së Tiranës dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, gjë që u konfirmua edhe nga Kryetari i Bashkisë Z. Erion Veliaj.

Takime të kësaj natyre, që synojnë të krijojnë një model të ri qeverisjeje dhe vendimarrjeje që mbështetet e përfaqëson edhe qëndrimin dhe interesat e shoqatave të shoqërisë civile, në territorin e bashkisë së Tiranës, do të përfshihen në programin qeverisës së bashkisë dhe do të zhvillohen në mënyrë periodike.



Një pikë e rëndësishme që u diskutua në takim, ishte promovimi i vullnetarizmit dhe shkëputja nga mentalitetet që pengojnë zhvillimin e shoqatave të shoqërisë civile për të qenë më aktive në përfshirjen e të rinjve drejt vullnetarizmit dhe realizimin e misionit të tyre qytetar dhe të nismave për këtë qëllim. Më konkretisht, të gjitha shoqatat u ftuan të bëhen pjesë e aksionit të bashkisë për pastrimin e Tiranës më datë 4 Shtator si dhe për të dhënë një kontribut të vazhdueshëm që aksioni ndaj ndotjes së territorit të ketë rezultate konkrete, të prekshme e të qëndrueshme.



Shumë nga anëtarët e shoqatave pjesëmarrëse në këtë takim, vlerësuan nismën e rëndësishme të ndërmarrë nga Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Veliaj për pastrimin e qytetit në datën 4 shtator 2015, duke konfirmuar kështu angazhimin e tyre qytetar.

Kryetari i Bashkisë theksoi se takime të tilla do të vijojnë në muajt në vazhdim duke i bërë periodike me qëllim vendosjen e piketave për një bashkëpunim të qëndrueshëm mes institucioneve dhe shoqërisë civile dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshme mes tyre.

Në mbyllje, AMSHC i fton te gjithë të interesuarit të ndjekin aktivitetet e ardhshme të agjencisë, dhe të parashtrojnë idetë dhe sugjerimet e tyre, me qëllim që ky bashkëpunim të jetë sa më i frytshëm.



AMSHC i bashkohet aksionit qytetar "TË PASTROJMË TIRANËN"

Tiranë, 4 shtator 2015

Nismës për pastrimin e Tiranës më datë 4 shtator 2015, të lançuar nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Z. Erion Veliaj, iu bashkua edhe stafi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC).

Të pajisur me bluzat me moton "TË PASTROJMË TIRANËN" si edhe me mjetet e nevojshme për aksionin qytetar të pastrimit, stafi i AMSHC-së i kryesuar nga Drejtori Ekzekutiv, Z. Andi Kananaj, u organizua për të kryer pastrimin e zonave të përcaktuara më parë.


Rreth orës 9:00 nisi aksioni i pastrimit fillimisht në zonën përreth rrugës "Frosina Plaku", për të vijuar dhe më tej me zona të tjera.

Stafi i AMSHC-së hasi edhe grupe të tjera qytetarësh, të cilët ishin po aq aktivë dhe të ndërgjegjësuar për realizimin e kësaj nisme.

Pas disa orësh dhe në përfundim të këtij aksioni pastrimi, stafi i AMSHC-së vendosi pranë kontenierëve të zonës, thasët e zinj me mbeturinat e mbledhura.

I gjithë ky aksion pastrimi u shoqërua me fotot përkatëse të fillimit dhe mbarimit të punës, sipas të cilave u evidentua qartë rezultati i pritshëm.

Shembuj të tillë vullnetarizmi ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjjes qytetare për mbajtjen pastër të ambjenteve të përbashkëta si edhe kontribuojnë në mbarëvajtjen e punës së Bashkisë së Tiranës për pastrimin e qytetit tonë.



Shpallet lista e projekteve fituese të Thirrjes Nr. 8

29 shtator 2015

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC)
falënderon të gjithë aplikantët pjesëmarrës në këtë thirrje
për interesin e shprehur me projekt-propozime.

Për më shumë informacion vizitoni faqen zyrtare www.amshc.gov.al

Konferencë dhe Panair Kombëtar i Sipërmarrjeve Turistike

Tiranë, 30 shtator 2015

Përfaqësues i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), z. Kastriot Tota, mori pjesë në një Konferencë dhe Panair Kombëtar i Sipërmarrjeve Turistike, e cila u zhvillua në ambientet e Qendrës Turistike "Panorama Dajt" në Tiranë.

Ky aktivitet u organizua nga Shoqata e Restoranteve Turistike Shqiptare, në të cilin morën pjesë deputetë të Parlamentit Shqiptar, përfaqësues të ambasadave, agjensive turistike, sipërmarrjeve turistike, institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të shoqatave që merren me promovimin e turizmit në vendin tonë.



Konferenca e cila u zhvillua me rastin e Ditës Botërore të Turizmit, u përshëndet nga përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Kryetari i Njësisë Administrative Dajt, Drejtori Ekzekutiv i Grupit ICDQ Italia, Unioni i Operatorëve Turistik, etj.

Një pikë e rëndësishme që u diskutua në takim, ishte promovimi i turizmit në Shqipëri.

Më konkretisht, të gjitha shoqatat u ftuan të bëhen pjesë marrëveshjeve dhe trajnimeve për të rritur cilësinë e shërbimeve turistike.

